


## KRIKKA DHE RECENSIONE

# NJË LIBËR PËR KONFERENCËN E BUJANIT ME RASTIN E 80-VJETORIT TË SAJ

*(Alban Dobruna, Konferenca e Bujanit - Gurthemel i shtetësisë së Kosovës (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, IH, Prishtinë, 2023, f. 383)*



E vlerësuar si njëra nga ngjarjet më me rëndësi të historisë së popullit shqiptar, Konferenca e Bujanit i zhvilloi punimet nga 31 dhjetori 1943 dhe vazhdoi më 1 e 2 janar 1944 në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Kjo konferencë u organizua me iniciativën e Shtabit Kryesor të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës. Të pranishëm gjatë këtij vendimi ishin edhe përfaqësues nga shtabi i Ushtrisë Nacional Çlirimtare për Kosovë dhe Metohi të asaj

kohe dhe nga komitete të vendit të Partisë Komuniste Jugosllave. Kishte pjesëmarrës nga pothuajse të gjitha viset shqiptare në ish-Jugosllavi. Ishin paraparë që të merrnin pjesë 61 delegatë, por u mbajt vetëm me 49. Kjo ngjarje e rëndësishme, deri në vitet 70, nuk u përmend në përmasa të konsiderueshme. Pas viteve 80 kishte diskutime të zgjeruara, ku ishin përfshirë njerëzit e politikës dhe të shkencës. Rrjedhimisht, pas viteve 80 u organizuan edhe tryeza e konferenca shkencore në lidhje me këtë organizim. Një ngjarje si kjo, sigurisht se do të duhej të trajtohej edhe në nivel të monografive të veçanta nga historiografia shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore. Siç dihet, shumë ngjarje të periudhës së Luftës së Dytë Botërore, e posaçërisht ato që lidheshin me Luftën Nacional Çlirimtare, nga historiografia shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë janë trajtuar mjaft, duke u organizuar konferenca shkencore, botuar kujtime, monografi etj., por çuditërisht një ngjarje e rëndësishme si

Konferenca e Bujanit disi u anashkalua. Sigurisht se ka edhe arsye, sepse siç dihet, në këtë konferencë kishte diskutime të ngjeshura rreth tekstit të rezolutës, ku kërkohej të potencohej vullneti i popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë dhe, me interferimin e delegatëve serbo-malazezë, u vendos që të potencohej në rezolutë e drejta për vendvendosje pas përfundimit të luftës, megjithatë kjo e drejtë pas Luftës së Dytë u mohua shqiptarëve të Kosovës.

Deri më sot, për këtë ngjarje ka pasur diskutime, janë mbajtur konferenca. Intensiteti më i madh për ta trajtuar këtë konferencë ishte pas viteve 90. Por, për aq sa jemi në dijeni, deri më sot kanë munguar botimet monografike për këtë temë, andaj nisur edhe nga ky fakt studiuesi dr. doc. Alban Dobruna i ka hyrë punës për ta finalizuar një studim mbi këtë konferencë dhe, duke përdoruar materiale e burime arkivore, mendojmë se ia ka dalë. Kjo monografi, studiuesin Dobruna e radhit të parin që boton libër të këtij formati për këtë konferencë. Studimi, përveç parathënies, përfundimit dhe burimeve e literaturës, përbëhet nga katër kapituj.

*Kapitulli i parë* titullohet “Arsimi i kadrove shqiptare dhe

përhapja e ideve komuniste”. Në këtë kapitull autori Dobruna trajton përhapjen e ideve majtiste në Kosovë, të cilat erdhën përmes disa shkrimeve e revistave që botoheshin në gjuhën shqipe në dekadën e parë të shekullit XX, si: “Shqypeja e Shqypënisë”, “Socijalistička zora” (“Agimi socialist”) dhe “Shkupi” etj. Prijatarët e këtyre ideve në Kosovë ishin: Zef Lush Marku, Ilija Krasojeviqi, Muharrem Ali Tarambaba, Haxhi Shejh Ymer Paçarizi, Sheh Hasani (me origjinë nga Plava, por që vepronte në Gjakovë).

Një rrugë tjetër e përhapjes së ideve majtiste në Kosovë, sipas autorit Dobruna, ishte ajo përmes Shqipërisë, respektivisht përmes nxënësve nga Kosova, të cilët u shkolluan në shkollat e Shqipërisë (Shkodër, Elbasan, Korçë etj.) në periudhën në mes dy luftërave botërore, si: Hajdar Dushi, Fadil Hoxha, Emin Duraku etj. Arsyeja pse nxënësit shqiptarë nga Kosova shkuan për shkollim në Shqipëri ishte se në periudhën mes dy luftërave botërore në vendin tonë nuk kishte shkolla në gjuhën amtare. E vetmja shkollë e mesme ku mund të shkolloheshin edhe shqiptarët ishte Medreseja e Madhe “Mbreti Aleksandër I” në Shkup, por kjo shkollë ishte e pamjaftueshme për nevojat e

popullatës shqiptare në ish-Jugosllavi.

*Kapitulli i dytë* titullohet “Organizimi i rezistencës antifashiste në Kosovë”. Studiuesi Dobruna në këtë kapitull trajton organizimin e rezistencës antifashiste në Kosovë, bashkëpunimin e brigadave partizane jugosllave, ku bënin pjesë edhe shqiptarët e ish-Jugosllavisë, me ato shqiptare, duke vërtetuar se shqiptarët ishin pjesë edhe e koalicionit antifashist, sado që propaganda serbe e pas-Luftës së Dytë Botërore këtë fakt është munduar t’ua mohojë shqiptarëve. Gjithashtu, studiuesi Dobruna potencon edhe rolin konstruktiv që luajti organizata Lidhja e Dytë e Prizrenit në këtë kohë. Për autorin kjo organizatë “nuk ishte një organizatë tradhtare, siç u interpretua një gjysmë shekulli në historiografinë komuniste. Ajo ishte një organizatë politike e ushtarake, që u përpoq me guxim, për të krijuar një Shqipëri etnike (f. 91)”.

*Kapitulli i tretë* titullohet “Thirrja e Konferencës së Bujanit”. Aty studiuesi Dobruna flet për organizimin e kësaj mbledhjeje, e cila u thirr nga përfaqësuesit e Shtabit Krahinor të UNÇ –së të Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit dhe të KK të PKJ-së, por të sponsorizuar nga Tefik Çanga,

një afarist i suksesshëm i asaj kohe. Qëllimi i mbledhjes ishte unifikimi i grupeve partizane dhe nacionaliste të asaj kohe. Studiuesi Dobruna në këtë kapitull shkruan për rezolutën, strukturën shkollore të pjesëmarrësve etj., jehonën që bëri kjo konferencë në qarqet e asaj kohe dhe rolin e oficerëve ndërlidhës britanikë në këtë konferencë.

*Kapitulli i katërt* titullohet “Reagimet e PKJ-së dhe PKSh-së ndaj Konferencës së Bujanit”. Sipas studiuesit Dobruna disa qarqe destruktive, si Millovan Gjillasi, do të reagojnë ndaj kësaj konference, sepse vendimet e saj nuk kishin ne korrelacion me apetitet e tyre shoviniste. Millovan Gjilasi në letrën e tij, dërguar më 28 mars 1944 (e shkruar në emër të KQ të PKJ), ndonëse e shkruar me mjeshtëri dhe në frymën vendimeve të mbledhjes së dytë të KANÇJ, Konferencën e Bujanit do ta dënonte për dy problemet themelore. Në të u sulmua sanksionimi që i bëri Konferenca të drejtës së popullit shqiptar për vetëvendosje deri në shpëputje, si edhe barazia e krahinës me viset e tjera të Jugosllavisë. Ndërsa PKSh-ja nuk kishte reagime të fuqishme, sepse sipas studiuesit Dobruna, Tito arriti të mbante pezull çështjen shqiptare dhe të

bindte Komitetin Qendror të PKSH-së se problemi shqiptar dhe i viseve të okupuara nga Jugosllavia do të zgjidhej pas mbarimit të luftës, që në fakt nuk ndodhi, sepse popullit shqiptar të Kosovës iu mohua kjo e drejtë, duke e mohuar praktikisht atë që ndodhi në Bujan.

Historiografia shqiptare këtë konferencë e ka shikuar në aspektin ideor si pararendëse e pavarësisë së Kosovës, e bashkimit kombëtar, por edhe si ndodhi e patjetërsueshme në rrethanat kohore, e studiuesi Dobruna këtë konferencë e ka precizuar *gurthemel të shtetësisë së Kosovës*.

Duke shfletuar librin mund të përfundojmë se studiuesi Dobruna ka mbledhur materiale të botuara për këtë konferencë deri më sot, i ka sistemuar dhe komentuar. Këto materiale i ka plotësuar edhe me dokumente të hulumtuara në arkivat e rajonit dhe, si tërësi ka sjellë një studim të rëndësishëm në lidhje me Konferencën e Bujanit. Gjithashtu, duhet potencuar se ky studim i studiuesit Dobruna vjen në 80-vjetorin e përfundimit të punimeve të kësaj konference, çka e bën edhe më të rëndësishme këtë prurje.

Nuridin AHMETI